



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY



DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

04/4131/2025

Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028

HANI I ELEZIT, QERSHOR

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028 është përgatitur dhe hartuar nga Grupi Punues, në kuadër të planifikimeve fillestare buxhetore dhe politikave zhvillimore.

Anëtarët e Grupit Punues:

1. **Sevdi Dernjani** – Nënkyetar i Komunës Hani i Elezit,
2. **Florim Shkreta** – Kryesues i Kuvendit Komunal,
3. **Lindita Ballazhi** – Drejtore e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
4. **Natyra Kalisi** - Drejtore e Drejtorisë së Administrës së Përgjithshme,
5. **Kimete Kuka Hasallari** - Drejtore e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,
6. **Hisni Luri** – Drejtor i Drejtorisë për Arsim dhe Shkencë,
7. **Majlinda Kaloshi** - Drejtore e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm,
8. **Arsim Dernjani** – Drejtor i Drejtorisë Shërbime Publike, Mbrojtja Civile dhe Emergjencë,
9. **Abduraman Bushi** – Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,
10. **Nexhmedin Daci** – Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit,
11. **Arbenita Bajramaliu** - Drejtore e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,
12. **Bajrush Laçi** – Shef i Zyrës Ligjore,
13. **Ali Axhami** – Zyrtar Kryesor Financiar,
14. **Resul Suma** – Shef i Grupit Parlamentar i PDK-së në Kuvendin Komunal,
15. **Hyrijete Isufi** - Shefe e Grupit Parlamentar e LDK-së në Kuvendin Komunal,
16. **Sherif Berisha** - Shef i Grupit Parlamentar i LVV-së në Kuvendin Komunal,
17. **Zaim Bela** - Shef i Grupit Parlamentar i AAK-së në Kuvendin Komunal.

1. Hyrje

Mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë muajit maj të këtij vitit, ka aprovuar Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve Qeveritare (KASH) për periudhën 2026 – 2028.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH 2026-2028) paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2026, i cili do të miratohet nga Asambleja Komunale. Qëllimi kryesor i KASH-it është që të ofrojë një analizë, e cila reflekton mjedisin makroekonomik në vend, për të vendosur kështu bazën për planifikimet buxhetore për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë.

Pas hartimit nga Ministria e Financave të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH 2026 – 2028), pason edhe Qarkorja Buxhetore për gjitha Organizatat Buxhetore mbi bazën e së cilës të gjitha OB-të njoftohen mbi instruksionet e hartimit të buxheteve të tyre për periudhën 2026 – 2028.

Qarkorja Buxhetore 2026/01 ofron udhëzimet e para të përgatitjes së buxhetit komunal, përfshirë këtu kalendarin kohor indikativ si dhe kufijtë fillestarë të financimit për komunat për periudhën 2026 – 2028. Bazuar në kufijtë fillestarë të përcaktuara nga Qarkorja Buxhetore 2026/01, Autoritetet Komunale janë angazhuar në përgatitjen e KAB-it 2026-2028 të Organizatës Buxhetore - 659 Komuna Hani i Elezit.

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale - KABK, siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu, KABK siguron mekanizmat e nevojshme, përmes të cilave, objektivat prioritare, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

KAB-i Komunal, është dokumenti i parë që i prinë procesit të hartimit të Buxhetit pas pranimit të Qarkores së parë Buxhetore që lansohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për çdo vit.

Kalendarin kohor të procesit buxhetorë sipas udhëzimeve të Qarkores Buxhetore 2026/01 po e paraqesim si vijon:

Organizatave buxhetore të nivelit lokal duhet t'i përmbahen këtij kalendar kohor në përgatitjen e propozim buxhetit:

1. 30 Qershor: Aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale,

2. 30 Shtator: Aprovimi i propozim Buxhetit Komunal për vitin 2026-2028 nga Kuvendi Komunal,
3. 30 Shtator: pas aprovimit të propozim Buxhetit nga Kuvendi Komunal, komunat janë të obliguara të dorëzojnë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dokumentet si në vijim:
 - Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal (nënshkruar nga Kryetari i Komunës).
 - Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunal për vitin 2026-2028, përfshirë projektet kapitale shumëvjeçare.
 - Tabelat e buxhetit komunal (BDMS dhe PIP):
 - ✓ Tabela 4.1 - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve për vitin 2026-2028 (kopje e shtypur prej SZHMB, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - ✓ Tabela 4.1.B - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve përmes klauzolës së investimeve dhe huamarrjes
 - ✓ Tabela 4.2 - financimi i projekteve kapitale për vitin 2026 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitin 2027-2028 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - ✓ Tabela 4.2.B - financimi i projekteve kapitale përmes klauzolës së investimeve dhe huamarrjes,

Më në detaje kemi paraqitur më poshtë fazat e procesit buxhetor komunal 2026:

1. Përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028:

- Dokument bazik i nivelit të lartë strategjik komunal, i cili pasqyron caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën përkatese sipas kategorive ekonomike.

2. Shqyrtimi i prioriteteve për programet komunale:

- Kryetari i Komunës, Drejtori i Financave dhe drejtorët e drejtorive komunale bëjnë shqyrtimin e politikave dhe prioriteteve në fushat e tyre sektoriale.

3. Kufijtë fillestarë specifik për programet buxhetore:

- Rekomandohet se kufijtë fillestarë specifik të programeve duhet të përcaktohen para datës 01 Korrik 2025 bazuar në projeksionet e vendosura të Qarkores 2026/01 nga MFPT.

4. Dorëzimi i propozim buxhetit komunal sipas programeve:

- Drejtorët e drejtorive bëjnë prezantimin e vlerësimeve të tyre buxhetore dhe propozimeve, përfshirë politikat e reja si dhe opsionet për kursime të mundshme.

5. Dëgjimet buxhetore:

- Seanca dëgjimore në secilën drejtori komunale me qëllim të shqyrtimit të buxheteve të propozuara si dhe dëgjime publike të hapura me publikun.

6. Shqyrtimi i buxhetit komunal nga Kuvendi Komunal:

- Kryetari i Komunës përmes drejtorisë së Financave dorëzon propozim-buxhetin në Kuvendin Komunal për shqyrtim dhe aprovim, jo më vonë se 01 Shtator 2025.

7. Aprovimi i buxhetit të propozuar nga Kuvendi Komunal dhe dorezimi në MFPT:

- Propozim buxheti komunal për vitin 2025 i aprovuar nga Kuvendi Komunal dorëzohet në MFPT deri më 30 Shtator 2025.

2. OBJEKTIVAT DHE PRIORITETET E KOMUNËS PËR VITET 2026-2028

Komuna e Hanit të Elezit bazuar në Strategjinë e sajë Zhvillimore dhe dokumenteve tjera të rëndësishme si: Plani Zhvillimor Komunal dhe ai i Hartave Zonale, Plani Rregullativ Urban etj, synon t'i arrijë gjita objektivat e paraqitura në një periudhë afatmesme.

Në veçanti Strategjia Zhvillimore Komunale, trajton potencialin real zhvillimor të

Komunës krahas burimeve në dispozicion, si vijon:

1. Zgjidhja e problemit të mungesës së ujit dhe menaxhimit të rrjetit në të gjitha vendbanimet,
2. Verifikimi dhe certifikimi i instrumenteve për matjen e pluhurit dhe gazrave të SharrCem-it,
3. Ndryshimi i lokacioneve ekzistuese të paisjeve për matjen e emitimit të gazrave,
4. Përdorimi i burimeve alternative të energjisë për SharrCem,
5. Gjelbërimi i sipërfaqeve të eksploatuara nga SharrCem,
6. Zvogëlimi i nivelit të zhurmës që prodhohet nga SharrCem,
7. Vlerësimi i vazhdueshëm i popullatës dhe *punëtorëve/eve* në SharrCem për prezencën eventuale të fibrave të azbestit në trupin e tyre,
8. Në bashkëpunim me autoritetet doganore do të zvoglohet koha e pritjes së kamionëve në kufi,
9. Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza,
10. Trajtimi i qenve endacakë,
11. Mbrojtja nga prerjet ilegale të pyjeve duke vendosur pikat statike të kontrollit,
12. Vendosja e kamerave të vëzhgimit si dhe pajisjeve tjera adekuate në të gjitha hyrje-daljet në pyje,

13. Hapja e zyrës për mbrojtje të *qytetarëve/eve* për adresim të problemeve dhe nga mospërbushja e obligimeve kontraktuale,
14. Ndriçim i të gjitha rrugëve në qytet dhe vazhdim-përfundimi i ndriçimit të rrugëve në fshatra,
15. Rritje e hapësirave të gjelbëruara dhe atyre rekreative,
16. Aplikimi i projekteve të testuara të ndriçimit publik me baza solare,
17. Shenjëzim horizontal e vertikal në të gjitha rrugët e territorit të komunës,
18. Rritje e kapaciteteve për parandalimin dhe përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore,
19. Riorganizimi i ndërmarrjeve publike,
20. Krijimi i qendrës së alarmimit,
21. Vendosja e hidranteve në të gjithë zonat, përfshirë të gjitha fshatrat,
22. Kuadro të reja për *zjarrëfikësit/et*,
23. Implementimi i masave të sigurisë nëpër të gjitha objektet sidomos ato publike,
24. Vendosja e një partneriteti të ngushtë me mërgatën me qëllim të zhvillimit të projekteve komunale,
25. Subvencionimi i bizneseve me mjete monetare,
26. Promovimi i potencialeve që ka komuna me qëllim të nxitjes së investimeve,
27. Funkcionalizimi i zonës ekonomike dhe krijimi i zonave të reja,
28. Krijimi i plantacioneve të reja me pemë e perime,
29. Promovimi dhe subvencionimi i blegtorisë,
30. Krijimi i zyrës për zhvillim ekonomik,
31. Hartimi i Strategjisë për promovimin e potencialeve zhvillimore,
32. Organizimi i konferencave dhe punëtorive me fokus ekonominë,
33. Krijimi i lehtësirave për të bërit biznes,
34. Rritja e të hyrave vetanake,
35. Financim shtesë nga Qeveria, përveç Granteve Qeveritare,
36. Aplikimi digjital (web faqe) i kërkesave nga *qytetarët/et*,
37. Publikimi i të gjitha shpenzimeve komunale në formë të rregullt,
38. Asfaltimi i të gjitha rrugëve në qytet,
39. Kompletimi i infrastrukturës (ujësjelles dhe rrugë) në të gjitha fshatrat,
40. Ndërtimi i nënkalimeve-mbikalimeve,

41. Ndërtimi i fushave rekreative sportive,
42. Ndërtimi i parkingjeve,
43. Renovimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF),
44. Funksionalizimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare (AMF) në fshatin Gorancë,
45. Konsolidimi i shërbimit të emergjencës dhe avancimi i tij në qendër të shërbimit të emergjencës,
46. Shtimi i vizitave mjekësore shtëpiake,
47. Rritja e shkallës së mbështetjes me furnizime ushqimore për familjet në nevojë,
48. Rritja e mbështetjes së organizatave të personave me nevoja të veçanta,
49. Rritja e kujdesit shëndetësor ndaj familjeve të personave me nevoja të veçanta,
50. Rregullimi dhe mirëmbajtja e sallave dhe fushave sportive në të gjitha shkollat,
51. Pajisje e shkollave me kabinete e laboratorë,
52. Hapja e drejtimeve profesionale në shkollën e mesme të lartë,
53. Krijimi i mundësive që Hani i Elezit të ketë një bibliotekë qendrore,
54. Instalimi i kamerave në të gjitha shkollat e komunës,
55. Digjitalizimi i mësimi dhe i bibliotekave shkollore,
56. Bashkëpunim në formë binjakëzimi me shkollë jashtë vendit, për këmbim të përvojave dhe metodave,
57. Rritje të numrit të bursave për *studentë/e*,
58. Ndërtimi i shkollës fillore në “Lagjen e Re”,
59. Rishikimi dhe finalizimi i Planit Zhvillimor Komunal,
60. Plane rregulluese të hollësishme për zonat ku do të jetë e nevojshme,
61. Formimi dhe funksionalizimi i një zyre shërbyese vetëm për nevojat e urbanizmit,
62. Rritja e pjesëmarrjes së *qytetarëve/eve* në procesin e planifikimit hapësinor e buxhetor,
63. Trajtimi i objekteve të ndërtuara pa leje,
64. Subvencionimi i *fermerëve/eve* për ngritjen e serrave,
65. Funksionalizimi i një skene verore, ku do të organizoheshin koncerte e shfaqje tjera,
66. Ngritja e qendrave të reja rinore në fshatra,
67. Rritja e përkrahjes financiare e aktiviteteve sportive, kulturore e rinore,
68. Investimet në monumente të cilat rrezikojnë të shkatërrohen,

69. Organizimi i manifestimeve e takimeve të ndryshme kulturore, shoqërore e sportive gjatë periudhes së ardhjes së diasporës,
70. Promovimi i potencialit turistik që ka komuna jonë në malet përreth si Kodra e Staneve, Puset e Nikës, Pishat në Krevenik, Lumi Lepenc,
71. Përcaktimi i zonave turistike dhe arkeologjike të komunës,
72. Rivitalizimi i objekteve të trashëgimisë kulturore,
73. Hartimi i rregullores për sportin në Hanin e Elezit, e cila do përfshijë kushtet financiare të funksionimit të klubeve, pagesat e pagave të sportistëve dhe institucionalizimi si klube zyrtare apo të sponsorizuara nga bizneset lokale,
74. Krijimi i fondit për sportin bazuar në donacionet dhe sponsorimet e bizneseve,
75. Ndërtimi i qendrave inovatore për të rinjtë,
76. Formimi i ligës së futbollit dhe voleybollit në shkolla fillore dhe të mesme,
77. Ndërtimi i terreneve sportive në lagje të qytetit, si dhe në të gjitha fshatrat e komunës sonë.

2.1 VEPRIMET QË KANË TË BËJNË ME OBJEKTIVAT

ZHVILLIMI EKONOMIK DHE TURIZMI

1. Promovimi i Komunës së Hanit të Elezit në rajon

1. Organizimi i panairove vendore,
2. Hartimi dhe plotësimi i dokumenteve informative dhe prezantimi i tyre përpara komuniteteve duke përfshirë kampanja, webfaqe promovuese, evente të ndryshme,
3. Hartimi i strategjive të ndryshme sektoriale,
4. Fushata promovuese përmes potencialeve zhvillimore duke përfshirë pikat me mundësi turizmi,
5. Organizimi i takimeve informuese rreth mundësive zhvillimore të komunës me mërgatën dhe mundësive për investime,
6. Shenjëzimi apo vendosja e tabelave informuese për zonat me rëndësi,
7. Pjesëmarrje në panairot ndërkombëtare duke promovuar vlerat e komunës.

2. Zhvillimi i pikave me potencial turistik

1. Hartimi i Strategjisë për Turizëm,
2. Dizajnimi i parqeve rekreative në fshatin Gorancë dhe në Paldenicë,
3. Krijimi i hapësirave turistike malore dhe krijimi i mundësive për bujtina dhe gastronomi,
4. Krijimi i shtigjeve të ecjes dhe çiklizmit malor nëpër zonat rurale,
5. Investime të mëtutjeshme tek Bllaca 99,
6. Rregullimi i hapësirës tek zona e shkronjave “UÇK”,

7. Hartimi digjital i Hartës Turistike.

3. Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik

1. Shqyrtimi i Hartave Zonale të Komunës,
2. Rregullimi i infrastrukturës teknike për zonat ekonomike të caktuara,
3. Rregullimi i infrastrukturës së Tregut Ditor në qytet,
4. Minimizimi i ndotjes në mjedis nga industritë prodhuese dhe faktorët ndotës të tjerë,
5. Shtimi i shiritave të gjelbërimit pranë zonave ekonomike dhe zonave urbane ku ndotja është më e theksuar,
6. Investimet tek burimet e ujit mineral në Han të Elezit në partneritet publiko-privat,
7. Partneritet me donatorët e jashtëm për përkrahjen e bizneseve prodhuese lokale për mundësitë e eksportit të prodhimeve,
8. Mbështetja/subvencionimi i bizneseve inovative fillestare në bazë vjetore,
9. Organizimi i takimeve informuese dhe aktiviteteve të tjera me qëllim të orientimit në karrierë dhe aftësimin për punë,
10. Angazhimi i praktikantëve të rinjë në institucionet publike me qëllim të përfitimit të përvojave institucionale,
11. Hartimi i programeve për ringjalljen e zanateve të vjetra,
12. Organizimi i konferencave dhe punëtorive me fokus ekonominë.

ARSIMI

1. Rritja e përfshirjes dhe qasje e barabartë në edukimin në fëmijërinë e hershme

1. Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore,
2. Rregullimi i hapësirave të jashtme shkollore,
3. Rregullimi i infrastrukturës në Institucionin Parashkollorë,
4. Mirëmbajtja dhe furnizimi i vazhdueshëm me inventar dhe pajisje të nevojshme për institucionet arsimore .

2. Ngritja e cilësisë në arsimin parauniversitar

1. Konsolidimi i mekanizmave për sigurim të cilësisë dhe ofrimit të trajnimeve për mësimdhënie më cilësore,
2. Punëtori me fokus orientimin në profesion.

KULTURË RINI DHE SPORT

1. Promovimi i kulturës dhe sportit në Han të Elezit

1. Përgatitja e kalendarit dhe shënimi i aktiviteteve,
2. Organizimi dhe pjesëmarrja në gara komunale dhe ndërkomunale,
3. Kampanja promovuese,
4. Akademi dhe evente të ndryshme,
5. Panaire vendore dhe ndërkombëtare,

6. Subvencionimi i OJQ-ve,
7. Përkrahja e sh.k.a Sharri në manifestime kombëtare dhe ndërkombëtare,

2. Rivitalizimi i objekteve me trashëgimi

1. Infrastruktura e përmirësuar tek shkolla Muze,
2. Konzervim dhe restaurimi i objekteve me trashëgimi në Puset e Nikës,
3. Intervenimi në depot e parkut të qytetit dhe kthimi i tyre në hapësira për ekspozita.

3. Hartimi i planit për rini

1. Organizimi i festivale, Teatrove, Muzikaleve, Shfaqjeve Dokumentareve,
2. Organizimi i ekspozitave në pikturë dhe skulpturë,
3. Hiking ecje në male.

SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE

1. Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore

1. Fushata sensibilizuese për parandalimin e sëmundjeve të ndryshme,
2. Rifunksionalizimi i sektorit të stomatologjisë,
3. Aktivitete të ndryshme në ditët ndërkombëtare të shëndetësisë.

2. Shërime të përmirësuara në shërbimet sociale

1. Hartimi i planit për banim social,
2. Aktivitete dhe fushata të ndryshme në kuadër të shërbimeve sociale,
3. Pajisja e Komunës me plane hapësinore.

URBANIZËMI DHE MBROJTJE TË AMBIENTIT

1. Mbrojtja e mjedisit nga ndotja

1. Hartimi i Planit të ri Zhvillimor të Komunës,
2. Hartimi i Hartës Zonale,
3. Hartimi i planit të ri rregullues urban për zonën qendër të Hanit të Elezit,
4. Zbatimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis.

BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

1. Vetëdijësimi i lartë rreth fermave

1. Organizimi i panairit lokal,
2. Promovimi i bujqësisë përmes rrjeteve sociale,
3. Fushata sensibilizuese për bujqësi organike,
4. Hartimi i strategjive për mbështetje të fermave.

2. Zhvillimi i fermave

1. Subvencionimi i fermave,
2. Rehabilitimi dhe ndërtimi i sistemeve të ujitjes,
3. Krijimi i qendrave grumbulluese të produkteve bujqësore,
4. Hartimi i planeve për menaxhimin e kullosave,
5. Organizimi i trajnimeve për fermerët.

SHËRBIMET PUBLIKE

1. Mirëmbajtja e hapësirave publike

1. Mirëmbajtja e rrugëve lokale verë-dimër, hapësirat publike, varrezat etj,
2. Mirëmbajtja e ndriçimit publik,
3. Mirëmbajtja e kanalizimit,
4. Shtrimin e ndriçimi për dekorimin e qytetit.

2. Ofrimi cilësor i shërbimeve publike

1. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal,
2. Pastrimin e deponive ilegale,
3. Vendosjen e shportave të mbeturinave nëpër qytete dhe fshatra.

2.2 PËRSHKRIMI I KOMUNËS DHE PROFILI EKONOMIK



Figura 1: Pozita gjeografike e komunës së Hanit të Elezit

Komuna ka gjithsej 11 zona kadastrale, dy prej të cilave kanë qenë të shpopulluara që nga viti 1999. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës nga regjistrimi i popullësisë së vitit 2011, Komuna e Hanit të Elezit ka 9.403 banorë.

Në pjesën jug-lindore të Kosovës shtrihet Hani i Elezit, qytet në afërsi të pikës kufitare të Republikës së Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, pjesë territoriale që përfshinë një sipërfaqe prej 83 km². E rrethuar nga kufijtë natyror që përbëhen nga malet e bukura të Sharrit dhe Karadakut të Shkupit, qyteti i Hanit të Elezit shtrihet në fushëgropën që e ndanë lugina e lumit Lepenc. Kufijtë administrativ përfshijnë Komunën e Kacanikut dhe pjesën e Maqedonisë së Veriut, si shtet fqinj, ndërsa rrethohet nga 11 vendbanimet që ka. Vendbanimi i qytezës së Hanit të Elezit ka një pozitë gjeografike shumë të përshtatshme pasi që është një kryesore për qarkullimin e rrugëve Prishtinë-Shkup, duke përfshirë magjistralen dhe autostradën “Arbën Xhaferi”. Nga kjo pozitë e favorshme ka rezultuar me industri shumë të zhvilluar dhe të njohur jo vetëm për Kosovën por edhe për vendet jashtë saj. Transporti i mallrave kryhet përmes pikës së njohur kufitare në Han të Elezit, pikë kyçe për rajonin duke rezultuar me tregti dhe transport mjaft të zhvilluar. Rruga Magjistrale Prishtinë-

Shkup rreth 12 km e gjatë në territorin e Hanit të Elezit, kalon përmes Grykës së Kaçanikut, lidh Hanit të Elezit dhe më tej deri në Maqedoninë e Veriut.

Klima e Hanit të Elezit është tipike kontinentale, me dimra të ashpëra dhe temperatura minimale që sillen nga -10 gradë Celsius deri në 5 gradë Celsius, dhe vera të nxehta me temperatura maksimale që arrijnë deri në 40 gradë Celsius. Muaji më i nxehtë është Korriku, ndërsa muaji me ftohtë është Janari. Në klimën e komunës ka një ndikim të fuqishëm nga lugina e Vardarit (klima e butë me ndikim të fortë gjatë dimrit që pasohet nga sasi të vogla të reshurave të borës) dhe Gryka e Kaçanikut (klimë tipike kontinentale me ndikim të fuqishëm gjatë verës). Zona është e karakterizuar nga reshje të dobëta, me një mesatare 476ml/m²/vit. Reshjet janë të dobëta gjatë verës dhe janë të forta në dhjetor dhe janar. Lagështia mesatare është rreth 65% (minimumi 51% dhe maksimumi 87%). Drejtimi kryesor i erës është veri - jug. Aktualisht nuk ka ndonjë stacion lokal klimatik në territorin e Komunës.

Sa i përket funksionimit institucional të Komunës së Hanit të Elezit, sikur edhe në të gjitha komunat tjera në Republikën e Kosovës, qeverisja lokale është e organizuar në dy shtylla, ekzekutivi, që përbëhet nga Zyra e Kryetarit, Drejtorive dhe stafi civil si dhe legjislativi, që përbëhet nga Kuvendi i Komunës.

Kryetari i Komunës është autoriteti më i lartë ekzekutiv në Komunë dhe zgjidhet direkt nga qytetarët. Aktualisht, ekzekutivi kryesohet nga kryetari i komunës z.Mehmet Ballazhi. Së bashku me Zyrën e Kryetarit të Komunës, janë nëntë drejtori të udhëhequra nga drejtorët/et e drejtorive:

- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë,
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,
- Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit,
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm,
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
- Drejtoria për Arsim dhe Shkencë.

3. VIZIONI DHE MISIONI I KOMUNËS

Hani i Elezit do të formsohet në rajon si nyje ekonomike, duke ndërtuar zhvillimin e saj mbi industrinë prodhuese, bujqësinë, trashëgiminë dhe duke shfrytëzuar pozitën gjeografike të saj rreth potencialeve natyrore për një shtrirje të horizontit në shumë sektor.

Deklarata e Misionit:

Kryetari i Komunës, përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj, udhëheq ekzekutivin e Komunës dhe administratën dhe mbikqyrë administrimin financiar të Komunës duke ushtruar të gjitha kompetencat, ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës, organizon punën dhe drejton politikën e Komunës; emëron dhe shkarkon drejtorët e drejtorive; propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës; propozon zhvillimin komunal, planet rregullative e investuese, propozon buxhetin komunal vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe ekzekuton buxhetin e miratuar, raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko – financiare dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës; si dhe ndërmerr aktivitetet e tjera që i caktohen me Statut të Komunës, Rregullore komunale apo akte të tjera ligjore dhe nënligjore të cilat janë në fuqi.

Deklarata e Vizionit:

Zhvillimi lokal ekonomik; planifikim urban e rural; shfrytëzimi i tokës dhe zhvillimit; mbrojtje e mjedisit lokal; ofrimi i shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, mbrojtja e ambientit; përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale; ofrimin sa më të mirë të arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, ofrimin e përkujdesit primar publik shëndetësor; ofrimin e mirëqenies sociale, përfshirë rritjen e nivelit të barazisë gjinore në të gjitha fushat, ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike: turizmin, aktivitetet kulturore, rinore etj.

4. KORNIZA FISKALE KOMUNALE PËR VITET 2026– 2028

Me Qarkoren Buxhetore janë përcaktuar Grantet Qeveritare për financimin e komunave për vitin 2026 dhe orientimet për vitet 2027-2028, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, Qarkorja përcakton edhe nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2026 si dhe parashikimin afatmesëm 2027-2028. Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2026, bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Me rastin e regjistrimit të popullsisë, të dhënat të cilat janë publikuar zyrtarisht nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në vitin 2024, Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 12.03.2025 ka aprovuar shtojcën 1 me të dhënat e reja nga regjistrimi i Popullsisë, në përputhje me nenin 35, paragrafi 2 të Ligjit N.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, të dhëna të cilat kanë shërbyer për përgatitjen e buxhetit komunal për vitin 2026-2028.

Procesi i buxhetit komunal merr parasysh këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël,
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës,
- Zbatimi i konceptit shumë vjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale, si dhe
- Përcaktimi i strukturës së shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve. Projektet kapitale shumë vjeçare duhet të raportohen në sistemin e Projekteve të Investimeve Publike (PIP) bazuar në performancë. Si rrjedhojë, nga komunat kërkohet të hartojnë strategjinë kornizë bazuar në synimet dhe objektivat të orientuara në rezultate.

Për vitin fiskal 2026 parashikohet një buxhet në lartësi prej 4,234,682.00 € apo një rritje prej 619,225.00 € apo për 17.12 % në raport me vitin 2025, kurse për vitin 2027 kemi një parashikim të buxhetit në lartësi prej 4,457,136.00 € apo një rritje prej 222,454.00 € ose 5.2 % në raport me vitin 2026, si dhe për vitin 2028 vlerësohet një buxhet prej 4,672,491.00 € apo një rritje prej 215,355.00 € apo për 4.8% më i madh në raport me vitin 2027.

Analizuar financimin sipas llojeve të Granteve Qeveritare, në periudhën vijuese 2026-2028, financimi nga **Granti i përgjithshëm** (GP), për vitin buxhetor 2026, do të kemi në dispozicion shumë prej 1,872,179.00 € apo një rritje prej 170,287.00 € apo 10.01 % në krahasim me vitin 2025.

Te **Granti Specifik i Arsimit**, në vitin 2026 parashikohet të jetë në shumë prej 1,429,646.00 € ose një rritje prej 262,012.00 € ose 22.44 % në krahasim me vitin 2025.

Te **Granti Specifik i Shëndetësisë**, i cili financim qeveritar është në shumë prej 576,137.00 € për vitin 2026, ku kemi një rritje në krahasim me vitin 2025 për 169,925.00 € apo 41.8%.

Te **të hyrat vetanake komunale (THVK)** për vitin 2026, parashikohet të jenë në lartësi prej 356,720.00 € apo një rritje prej 17,001.00 € apo 5.0 % në krahasim me vitin 2025, ndërsa për vitin 2027 THVK parashikohen të jenë në lartësi prej 383,895.00 € apo një rritje prej 27,175.00 € apo prej 7.6 % krahasuar me vitin 2026 , ndërkaj për vitin 2028 kemi një vlerësim prej 385,721.00 € apo një rritje prej 1,826.00 € apo prej 0.4% në krahasim me vitin 2027.

4.1 BURIMET E FINANCIMIT KOMUNAL PËR VITET 2026-2028

Struktura e financimit komunal përfshin:

- Grantin e Përgjithshëm,
- Grantin specifik për Arsim,
- Grantin specifik për Shëndetësi,
- Projektionet e të hyrave vetanake nga Komunitat.

4.1.1 Granti i përgjithshëm

Bazuar në Tabelën 1, të paraqitur në vijim, të përgatitur nga Departamenti i Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në përputhje me LFPL, Granti i Përgjithshëm për komuna për vitin 2026 është në shumë prej 345 milion euro, në të cilën është përfshirë edhe kostoja nga regjistrimi i popullsisë në shumë prej 6.5 milion euro, për të mbuluar ndikimin negativ në disa komuna, bazuar në nenin 35.3 të LFPL. Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL. Sipas këtij neni, 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore ju ndahen komunave, duke përjashtuar: mbështetjen buxhetore dhe grantet, grantet e përcaktuara të donatorëve, të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga interesi si dhe taksat, ngarkesat dhe të tjera nga qeveria lokale. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve Departamenti i Buxhetit 11 Siç paraqitet në tabelën në vijim, bazuar në vlerësimet të

Departamentit të Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar, të hyrat e përgjithshme qeveritare për vitin 2026 pritet të jenë 3,544.3 mil. euro. Nga kjo shumë, zbriten ato të hyra siç specifikohet në nenin 24 të LFPL dhe vijmë tek baza për ndarjen e grantit të përgjithshëm për komuna, i cili grant për vitin 2026 është në shumë prej 338.53 milion euro.

Tabela 1: Përcaktimi i vlerës së Grantit të Përgjithshëm për komuna 2026-2028 (mil. Euro).

Përshkrimi	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
A. Të hyrat e përgjithshme të Qeverisë	2,676.30	2,985.32	3,227.19	3,544.30	3,812.40	4,094.30
Zbriten:						
Mbeshtetja buxhetore dhe grante	(10.5)	(18.0)	(22.5)	(22.5)	(22.5)	(22.5)
Tatimi në pronë	(44.6)	(49.3)	(45.0)	(50.0)	(55.0)	(55.5)
Grantet e percaktuara të donatorëve	(12.0)	(12.0)	(12.0)	0.0	0.0	0.0
Taksa ngarkesa dhe të tjera nga Qeveria Lokale	(54.0)	(56.2)	(70.0)	(73.5)	(77.2)	(77.2)
Të hyrat nga interesi	(3.1)	(3.0)	(2.8)	(13.0)	(12.7)	(2.7)
B. Baza për llogaritjen e grantit të përgjithshëm për komunal	2,552.11	2,846.80	3,074.89	3,385.26	3,645.06	3,936.46
C. Granti i përgjithshëm për komuna (10%)	255.21	284.68	307.49	338.53	364.51	393.65

Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL:

1. numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%);
2. përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%);
3. numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%);
4. komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%).

Shpërndarja e grantit të përgjithshëm për Komunën Hani i Elezit për vitet 2026-2028

		Kriteret e ndarjes së Grantit të Përgjithshëm (sipas LFPL)												
Komuna	Popullsia	89 %	Madhësia Gjeografike	6 %	Popullsia Pakicë	3 %	Shuma Fikse (140,000 - 1€)	Shuma për popullsi 89 %	Shuma për madhësi gjeografike (6 %)	Shuma për popullsi pakicë në Komuna (3 %)	Shuma për Komunitat me popullsi pakicë (2 %)	GP për vitin 2026	GP për vitin 2027	GP për vitin 2028
Hani i Elezit	8,533	0.53 %	83.13	0.76 %	16	0.01 %	131,467	1,586,224	153,091	1,397	-	1,872,179	2,007,285	2,158,835

Tabela 2: Shpërndarja e Grantit të Përgjithshëm 2026-2028

Financimi i shërbimeve sociale si kompetencë e transferuar në Komuna përfshihet në kuadër të Grantit të Përgjithshëm të Komunës.

Të punësuarit në Administratën e Drejtorive Komunale për Arsim Parauniversitar dhe Shëndetësi Primare financohen nga Granti i Përgjithshëm në Komuna.

Po ashtu, nga Granti i Përgjithshëm do të plotësohen edhe Grantet Specifike për Arsim dhe Shëndetësi kur është e nevojshme.

1.1.2 *Granti Specifik për Arsim Parauniversitar*

Granti Specifik për Arsim para universitar sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit para universitar të MASHTI për vitin 2026-2028. Grantin specifik për arsim para universitar për vitin 2026 është në shumë prej 270.46 milion euro, si vijon:

Granti bazë në shumë prej 265.9 milion euro si vijon:

- o Paga dhe shtesa në shumë prej 247.4 milion euro,
